



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.17, datë.04.06.2024

PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË KUSHTEVE TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR
OBJEKTIN: “KOMPLEKS ME VILA DHE SHTËPI TË DYTA ME 1, 2 DHE 3 KATE MBI
TOKË, ME 1 KAT NËNTOKË DHE MUR RRETHUES”, ME VENDNDODHJE NË
LAGJEN “UJI I FTOHTË”, BASHKIA VLORË

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Hel-Pet” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të kushteve të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Kompleks me vila, shtëpi të dyta me 1, 2 dhe 3 kat mbi tokë, me 1 kat nëntokë dhe mur rrethues”, me vendndodhje në lagjen “Uji i Ftohtë”, Bashkia Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Hel-Pet”.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur Vendimit Nr. 22, datë 10.06.2021 të Këshillit Kombëtar të Territorit, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Dokumenti i Rregullores së Veçantë është pjesë përbërëse e këtij vendimi
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT , KULTURËS DHE SPORTIT
BLENDI GONXEHA



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshtkruar më datë 05/11 / 2025